



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 13 dhjetor 2013  
Nr. ref.:RK517/13

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI119/13**

Parashtrues

**Milija Mirković**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të  
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0003-  
A0001, të 16 majit 2013**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Milija Mirković nga fshati Bërnice, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati z. Shefki Sylaj nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Kontestohet Aktvendimi i Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0003-A0001, i 16 majit 2013, me të cilin u vërtetua aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës SCC-09-155, i 16 dhjetorit 2010, e me të cilin, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, është shkelur neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0003-A0001, i 16 majit 2013, me të cilin është përfunduar kontesti pronëso- juridik ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe disa personave juridikë lidhur me paluajtshmërinë e ngastrave kadastrale nr. 622, në sipërfaqe prej 0.87.83 ha dhe nr. 1387, në sipërfaqe prej 0.93.31 ha, të regjistruara në listën poseduese nr. 162, që i ishin marrë paraardhësve ligjorë të parashtruesit të kërkesës me aktvendimin për marrjen e tokës më 21 dhjetor 1964, në bazë të maksimumit të tokës.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa është bazuar në nenet 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 paragrafin 2 të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), më 5 gusht 2013.
6. Me Vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. 119/13, të 30 gushtit 2013), gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi u emërua Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, me Vendimin e Kryetarit, Nr. KSH. 119/13, u emërua Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 4 tetor 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 21 tetor 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtare raportuese, Arta Rama-Hajrizi, Kolegji shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu, i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

9. Paraardhësit ligjorë të parashtruesit të kërkesës, Stanoje Mirković, me aktvendim për marrje të tokës më 21 dhjetor 1964, në bazë të maksimumit të

tokës, i ishin marrë ngastrat kadastrale nr. 622, në sipërfaqe prej 0.87.83 ha dhe nr. 1387, në sipërfaqe prej 0.93.31 ha, të regjistruara në listën poseduese nr. 162.

10. Më 10 gusht 2009, parashtruesi i kërkesës, në mbështetje të Ligjit për kthimin e tokës bujqësore të vitit 1991, paraqiti padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që kanë të bëjnë Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit kundër së paditurës KBI „Kosova Export Import“, me seli në Fushë-Kosovë.
11. Parashtruesi i kërkesës në kërkesëpadi ka kërkuar t'i njihet e drejta e pronësisë mbi paluajtshmërinë, e regjistruar si ngastra kadastrale nr. 622, në vendin e quajtur „Deja“, në sipërfaqe prej 0.87.28 ha dhe ngastra kadastrale nr. 1387, në vendin e quajtur „Pojatište Lazovi“, në sipërfaqe prej 0.97.31 ha dhe që këto ngastra kadastrale të regjistrohen në emër të tij në librat kadastralë të Zyrës së Kadastrës të Komunës së Prishtinës.
12. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, me Aktvendim SCC-09-0155, të 1 prillit 2010, propozoi zgjerimin e kërkesëpadisë edhe ndaj Kooperativës bujqësore NSH „Nëntë Jugoviqët“ në Bardhosh.
13. Parashtruesi i kërkesës duke vepruar sipas propozimit të gjykatës, e zgjeroi kërkesëpadinë edhe ndaj Kooperativës bujqësore NSH „Nëntë Jugoviqët“ në Bardhosh.
14. Zgjerimin e kërkesëpadisë e kontestuan përfaqësuesi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si administrator që administron me Ndërmarrjen shoqërore (NSH) KBI „Kosova Export“ në Fushë-Kosovë dhe përfaqësuesi i Kooperativës bujqësore.
15. Me Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme së Gjykatës Supreme të Kosovës, SCC-09-155, të 16 dhjetorit 2010, u refuzua kërkesëpadia e parashtruesit për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv të të paditurit të parë, Ndërmarrjes shoqërore (NSH) KBI „Kosova Export“ në Fushë-Kosovë, njëkohësisht e refuzoi kërkesën e parashtruesit për zgjerimin e kërkesëpadisë edhe ndaj KB „Nëntë Jugoviqët“ pasi që as Agjencia Kosovare e Privatizimit si *de facto* menaxher i KBI „Kosova Export“ (i padituri kryesor) dhe as NSH „Nëntë Jugoviqët“, nuk kishin dhënë pëlqimin lidhur me kërkesën për zgjerimin e padisë ndaj të paditurit të ri - NSH „Nëntë Jugoviqët“.
16. Parashtruesi i kërkesës ndaj Aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, SCC-09-155, të 16 dhjetorit 2010, ushtroi ankesë në Kolegjin e Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, mirëpo Kolegji i Ankesave, me Aktgjykimin ASC-11-003-A 001, të 16 majit 2013, e refuzoi ankesën për të njëjtat arsye, për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv, duke u thirrur në nenet 192 dhe 196 të Ligjit për procedurën kontestimore, duke theksuar:

*“... që nenet 192 dhe 196 të Ligjit për Procedurën Kontestimore janë aq të qartë sa nuk ka hapësirë për interpretim. Pëlqimi i të paditurit të ri është i obligueshëm në mënyrë që të zgjerohet padia kundër tij/saj. Kjo nuk varet nga Gjykata siç ka theksuar përfaqësuesi i paditësit. Për më tepër, nëse i*

*padituri tashmë ka hyrë në kontest për çështjen kryesore, pëlqimi i të paditurit të parë/kryesor është po ashtu i obligueshëm”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

17. Parashtruesi i kërkesës konsideron se “... nuk është dashur të refuzohet zgjerimi i kërkesëpadisë për hir të racionalitetit të procedurës dhe zgjidhjes së drejtë të kontestit, duke marrë parasysh që ngritja e padisë së re vetëm ndaj ndërmarrjes shoqërore „Nëntë Jugoviqët“ kërkon shpenzime dhe kohë shtesë deri sa të zgjidhet padia, ndërsa dihet shumë mirë stërzgjatja e procedurës në gjykata...”.
18. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon “... se në procedurat e lartpërmendura të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës është shkelur parimi i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm i garantuar me Kushtetutë dhe me Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, duke marrë parasysh se vetë Gjykata ka propozuar zgjerimin e kërkesëpadisë edhe ndaj të paditurit të dytë e pastaj e ka refuzuar padinë që do të thotë se Gjykata e ka vënë në lajthitje palën, e për pasojë e ka refuzuar kërkesëpadinë, rrjedhimisht është shkelur parimi i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm”.
19. Parashtruesi i kërkesës thekson se në këtë mënyrë është shkelur edhe neni 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me të cilin e drejta e pronës është e garantuar:

*“Paditësit i është cenuar e drejta e pronës në mënyrë arbitrare, kur i është marrë prona në bazë të maksimumit të tokës dhe është bartur në Fondin e Tokave Bujqësore të KBI „Kosova Export“, Fushë Kosovë. Kthimin e kësaj prone e garanton Ligji për Kthimin e Tokave i vitit 1991”.*

20. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Kushtetuese me këtë kërkesë:

*“Kërkojmë që aktgjykimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, SCC-09-0155, i 10.09.2009 dhe aktvendimi i Kolegjit të Ankesave të DHPGJSK, ASC-11-0003-A0001, i 16.05.2013 të shpallen të pavlefshëm dhe lënda të kthehet në rishqyrtim”.*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

21. Parashtruesi i kërkesës thotë se nenet 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe 46 (Mbrojtja e Pronës) të Kushtetutës janë bazë për parashtrimin e kërkesës së tij.
22. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
23. Neni 48 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.”*

24. Në bazë të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e apelit kur shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë ligjin dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës [DHM], Nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
25. Parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë provë *prima facie* që do të vërtetonte shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese (Shih, Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendim i GJEDNJ-së lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, Nr. 53363/99, 31 maj 2005). Parashtruesi i kërkesës nuk saktëson se në çfarë mënyre nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës e mbështesin kërkesën e tij, ashtu siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë cenuar të drejtat (Mbrojtja e Pronës) me zbatimin e gabuar të ligjit nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, duke mos qartësuar se në çfarë mënyre ai aktgjykim i ka cenuar të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.
27. Në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi për të paraqitur rastin e tij dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit për të cilin konsideron se është i gabueshëm, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe pranë Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur se procedurat përkatëse kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta ose arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendim i GJEDNJ lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, nr. 17064/06, 30 qershor 2009).
28. Përfundimisht, kushtet për pranueshmëri nuk janë plotësuar në këtë kërkesë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur ta mbështesë me prova pretendimin se me aktvendimin e kontestuar i janë cenuar të drejtat dhe liritë kushtetuese.
29. Nga kjo rrjedh se kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së punës që parashikon: „Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.”



## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 21 tetor 2013, njëzëri

## VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendimi do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

Arta Rama-Hajrizi



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Prof. dr. Enver Hasani